

Luajtës CD/DVD portativ

Udhëzimet e përdorimit



Për të mësuar sekrete, këshilla dhe informacione të dobishme rreth produkteve dhe shërbimeve Sony, ju lutemi vizitoni faqen: www.sony-europe.com/myproduct/



DVP-FX980

PARALAJMËRIM

Për të ulur rrezikun e zjarrit apo të goditjeve elektrike, mos e ekspozoni këtë aparat në lagështirë.

Për të shmangur goditjen elektrike, mos e hapni kabinetin. Për servis drejtójuni vetëm personelit të kualifikuar.

Kordoni elektrik duhet të zëvendësohet vetëm në dyqane të kualifikuara servisi.

Bateritë ose aparatura e instaluar me bateri nuk duhet të ekspozohen ndaj nxehtësisë së tepërur si drita e diellit, zjarri ose të ngjashme.

CLASS 1 LASER PRODUCT
LASER KLASSE 1
LUOKAN 1 LASERLAITE
KLASS 1 LASERAPPARAT

Kjo pajisje klasifikohet si produkt CLASS 1 LASER. Shenja CLASS 1 LASER PRODUCT MARKING ndodhet në pjesën e poshtme të njësisë.

KUJDES

Përdorimi i mjeteve optike me këtë produkt do të rrisë rrezikun ndaj syve. Duke qenë se rrezja e lazerit që përdoret në këtë luajtës CD/DVD është e dëmshme për sytë, mos u përpiqni të çmontoni kabinetin. Për servis drejtójuni vetëm personelit të kualifikuar.



Hedhja e pajisjeve të vjetra elektrike dhe elektronike (e aplikueshme në Bashkimin Evropian dhe shtetet e tjera evropiane me sistem të diferencuar grumbullimi)

Ky simbol mbi produkt ose mbi paketimin e tij tregon se produkti nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake.

Përkundrazi, duhet të dorëzohet pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike. Duke u siguruar që ky produkt të hidhet siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin, që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të këtij produkti. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore.

Për më shumë informacion të detajuar mbi riciklimin e këtij produkti, ju lutemi kontaktoni me bashkinë tuaj, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.



Pb

Hedhja e baterive të përdorura (e aplikueshme në Bashkimin Evropian dhe vendet e tjera evropiane me sisteme të diferencuara grumbullimi)

Ky simbol mbi bateri ose mbi paketim tregon se bateria e dhënë me këtë produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake. Në disa bateri, ky simbol mund të

përdoret së bashku me një simbol kimik. Simbolet kimike për zhivēn (Hg) ose plumbin (Pb) shtohen nëse bateria përmban më shumë se 0,0005% zhivē ose 0,004% plumb.

Duke u siguruar që këto bateri të hidhen siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të kësaj baterie. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore.

Në rast produktesh të cilat për arsye sigurie, performance apo integriteti të dhënash kërkojnë lidhje të qëndrueshme me një bateri të integruar, kjo bateri duhet të zëvendësohet vetëm nga personeli i kualifikuar shërbimi. Për të siguruar trajtimin e duhur të baterisë, dorëzoheni produktin në fund të periudhës së funksionimit të tij pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike.

Për të gjitha bateritë e tjera, ju lutemi shihni pjesën që flet mbi heqjen e sigurt të baterisë nga produkti. Dorëzoheni baterinë pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e baterive të përdorura.

Për më shumë informacion të detajuar mbi riciklimin e këtij produkti ose baterie, ju lutemi kontaktoni me bashkinë tuaj, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.

Mos e çmontoni dhe mos e rimodeloni luajtësin. Përndryshe, mund të shkaktoni goditje elektrike. Konsultohuni me shitësin ose qendrën më të afërt të servisit Sony për ndërrime të baterive të ringarkueshme, kontrolle të brendshme ose riparime.

Masat paraprake

- Instaloheni këtë sistem në mënyrë të atillë që kordoni elektrik të mund të hiqet menjëherë nga priza në rast problemi.
- Luajtësi nuk hiqet nga burimi i rrymës (rrjetit elektrik) për sa kohë që është e lidhur me prizën, edhe nëse luajtësi vetë është i fikur.
- Për të parandaluar rrezikun e zjarrit ose të goditjeve elektrike, mbi aparaturë nuk duhen vendosur objekte të mbushura me lëng, si p.sh. vazho.
- Trysnia e tepruar e zërit nga kufjet dhe minikufjet mund të shkaktojë humbje të dëgjimit.

Prodhuesi i këtij produkti është Sony Corporation, 1-7-1 Konan Minato-ku Tokyo, 108-0075 Japan. Përfaqësuesi i autorizuar për EMC dhe sigurinë e produktit është Sony Deutschland GmbH, Hedelfinger Strasse 61, 70327 Stuttgart, Germany. Për çdo çështje servisi ose garancie, ju lutemi referojuni adresave që jepen në dokumentet e veçanta të servisit ose të garancisë.

SHËNIM I RËNDËSISHËM



Kujdes: Ky luajtës është në gjendje të mbajë për një kohë të pacaktuar në ekranin e televizorit një foto ose figurë të palëvizshme video. Nëse këtë foto ose figurë të palëvizshme video e lini të shfaqet në televizor për periudha të gjata kohore, rrezikoni dëmtimin e përhershëm të ekranit të televizorit. Televizorët me ekran plazmë dhe me projektim preken nga kjo.

Nëse keni pyetje ose probleme në lidhje me luajtësin, ju lutemi kontaktoni shitësin më të afërt të Sony-t.

Informacion mbi të drejtat e autorit, markat tregtare dhe licencën e softuerit

- Prodhuar me licencë nga Dolby Laboratories. Dolby dhe simboli me dy “D” janë marka tregtare të Dolby Laboratories.
- “DVD Logo” është markë tregtare e DVD Format/ Logo Licensing Corporation.
- Patentat dhe teknologjia koduese audio MPEG Layer-3 janë të licencuara nga Fraunhofer IIS dhe Thomson.
- Të gjitha markat e tjera tregtare janë marka të pronarëve përkatës.
- KY PRODUKT LICENCOHET SIPAS LICENCËS SË PORTOFOLIT TË PATENTËS SË MPEG-4 VISUAL PËR PËRDORIM PERSONAL DHE JOTREGTAR NGA NJË KONSUMATOR PËR DEKODIMIN E VIDEOVE NË PËRPUTHJE ME STANDARDIN E MPEG-4 VISUAL (“MPEG-4 VIDEO”) QË JANË KODUAR NGA NJË KONSUMATOR I PËRFSHIRË NË NJË AKTIVITET PERSONAL DHE JOTREGTAR DHE/OSE ËSHTË MARRË NGA NJË OFRUES I SHËRBIMIT VIDEO I LICENCUAR NGA MPEG LA PËR TË OFRUAR MPEG-4 VIDEO. NUK JEPET OSE NUK NËNKUPTOHET ASNJË LICENCË PËR ÇFARËDO PËRDORIM TJETËR. INFORMACION SHITESË, DUKE PËRFSHIRË INFORMACIONIN QË LIDHET ME LICENCIMIN DHE PËRDORIMIN PROMOCIONAL, TË BRENDSHËM DHE TREGTAR, MUND TË MERRET NGA MPEG LA, LLC. SHIKONI [HTTP://WWW.MPEGLA.COM](http://WWW.MPEGLA.COM)

Për manualin

- Në këtë manual, “disk” përdoret si referencë e përgjithshme për DVD ose CD, përveç nëse pëcaktohet ndryshe nga teksti ose ilustrimet.
- Ikonat si **DVD**, që listohen në krye të çdo shpjegimi tregojnë llojin e mediave që mund të përdoret me funksionin që shpjegohet. Për hollësi shikoni “Media të luajtshme” (faqe 21).
- Informacioni i NEVOJSHËM (për të parandaluar përdorim të gabuar) listohet nën ikonën . Informacioni i DOBISHËM (këshilla dhe informacione të tjera të dobishme) listohet nën ikonën .


Pasqyra e lëndës

PARALAJMËRIM	2
Udhëzuesi për pjesët dhe kontrollet	5
<hr/>	
Përgatitja	8
Kontrolli i aksesorëve	8
Ngarkimi i i baterisë	8
Përdorimi i ushqyesit për bateri automjeti	9
Lidhja me televizorin	10
<hr/>	
Luajtja	11
Luajtja e disqeve	11
Luajtja e MP3, JPEG dhe skedarëve video	12
Rregullimi i cilësisë dhe i madhësisë së figurës	14
<hr/>	
Cilësimet dhe rregullimet	15
Përdorimi i konfigurimit të ekranit	15
<hr/>	
Informacione shtesë	17
Zgjidhja e problemeve	17
Masat paraprake	19
Media të luajtshme	21
Specifikimet	22
Indeksi	23

Udhëzuesi për pjesët dhe kontrollet

Funksonet e disponueshme ndryshojnë në varësi të diskut ose të situatës.

Luajtësi



Butonat VOLUME+ dhe ► (luaj) kanë një pikë të prekshme. Përdorni pikën e prekshme si referencë kur përdorni luajtësin.

1 Paneli LCD (faqe 11)

2 Altoparlanti

3 HOLD

Parandalon veprim aksidental të butonit kur shtypet për mbi dy sekonda.

Të gjithë butonat në luajtës janë të bllokuar, ndërsa butonat në telekomandë mbeten të përdorshëm.

SOUND

Kalon midis 4 modalitetesh të ndryshme të zërit çdo herë që shtypet.

4 DISPLAY

Shfaq informacionin e luajtjes dhe ndryshon modalitetin e luajtjes (faqe 12).

MENU

Shfaqe menynë DVD VIDEO. Kur luan skedarë JPEG luan fotoseri (faqe 13).



Lëviz theksimin për të zgjedhur artikullin e shfaqur.

ENTER

Fut artikullin e zgjedhur.

RETURN

Kthehet në ekranin e mëparshëm.

OPTIONS

Shfaq menynë e opsioneve.

- Disc/USB (faqe 13)
- LCD Mode (faqe 14)
- Setup (faqe 15)
- Menu/Top Menu: Shfaq menynë/menynë kryesore DVD VIDEO.
- Original/Play List: Zgjedh "Original" ose "Play List" në DVD VR.

5 VOLUME (volumi) +/-

Rregullon volumin.

6 ◀◀/▶▶ (para/pas)

Kapërcen në kapitullin, pjesën apo skedarin para/pas.

Vetëm butonat në luajtës kanë funksionet e mëposhtme.

- Kalon shpejt para/pas (◀◀/▶▶) kur shtypet për më shumë se një sekondë gjatë luajtjes. Shtypni në mënyrë të vazhduar për të ndryshuar shpejtësinë.
- Kalon me ngadalë para/pas (◀◀/▶▶) kur shtypet për më shumë se një sekondë gjatë pushimit. Shtypni në mënyrë të vazhduar për të ndryshuar shpejtësinë. (Luajtja prapa e ngadaltë është e disponueshme vetëm për DVD. Luajtja përpara e ngadaltë është e disponueshme për DVD, VIDEO CD dhe skedarë video.)

▶ (luaj) (faqe 11)

Nis ose rinis luajtjen.

▬▬ (pauzë) (faqe 11)

Vendos në pauzë ose rinis riprodhimin.

■ (ndalo) (faqe 11)

Ndalon luajtjen.

7 Kapaku i diskut (faqe 11)

8 PUSH OPEN/CLOSE (faqe 11)

Hap dhe mbyll kapakun e diskut.

9 Treguesi POWER

10 Treguesi CHARGE (faqe 8)

11 (sensori i telekomandës)

12 Çelësi OPERATE (faqe 11)

Fik ose ndez luajtësin.

13 Foleja PHONES (kufjet)

14 Foleja USB (tip A) (faqe 13)


Lidhni pajisje USB në këtë fole.

15 Foleja A/V OUT (faqe 10)

16 Foleja DC IN 12V (faqe 8, 9)

Lidhni ushqyesin AC ose ushqyesin e baterisë së automjetit.

Telekomanda



Butonat VOL +, numri 5, ▶ dhe AUDIO kanë një pikë të prekshme. Përdoreni pikën e prekshme si referencë kur përdorni luajtësin.

17 Butonat e numrave

Fut numrat e kapitujve/titujve etj.

CLEAR

Pastron fushën e vendosjes.

18 TOP MENU

Shfaq menynë kryesore të DVD VIDEO.

19 ◀◀REPLAY/▶▶ADVANCE

Riluan skenën/përshpejton shkurtimisht përpara skenën aktuale (vetëm DVD)

20 ◀◀◀◀/▶▶▶▶ (skanim/ngadalë)

- Çon shpejt prapa/shpejt përpara kur shtypet gjatë luajtjes së diskut. Shtypni në mënyrë të vazhduar për të ndryshuar shpejtësinë.
 - Kalon me ngadalë para/pas kur shtypet gjatë pauzës. Shtypni në mënyrë të vazhduar për të ndryshuar shpejtësinë. (Luajtja prapa e ngadaltë është e disponueshme vetëm për DVD. Luajtja përpara e ngadaltë është e disponueshme për DVD, VIDEO CD dhe skedarë video.)
-

21 ANGLE

Ndryshon këndet e regjistruara në një DVD VIDEO.

AUDIO

Ndryshon gjuhët e regjistruara në një DVD VIDEO me secilën shtypje. Kur luhet një CD ose VIDEO CD, kalon mes stereos dhe monos.

SUBTITLE

Ndryshon titrat e regjistruara në një DVD VIDEO sa herë që shtypet.


Kontrolli i aksesorëve

Kontrolloni nëse i keni artikujt e mëposhtëm:

- Ushqyesi (1)
- Ushqyesi për bateri automjeti (1)
- Përshtatësi audio/video (1)
- Telekomanda (1)
- Bateri R6 (përmasa AA) (2)

Përgatitja e telekomandës

Futni dy bateri R6 (përmasa AA) në mënyrë që polet e baterive ⊕ dhe ⊖ të përputhen me shenjat brenda folesë.




Ngarkimi i baterisë

Ngarkojeni baterinë e ringarkueshme përpara se të përdorni luajtësin për herë të parë ose kur bie bateria.

1 Lidhni ushqyesin.

Treguesi CHARGE ndizet gjatë ngarkimit.



Ngarkojeni baterinë në mjedisë me temperaturë midis 5°C dhe 35°C.

Koha e ngarkimit dhe e luajtjes

Koha e ngarkimit: rreth 4 orë


Koha e luajtjes: rreth 4 orë

Kohët e shfaqura janë në kushtet e mëposhtme:

- Koha e ngarkimit
 - temperatura mesatare (20°C)
 - fikja
- Koha e luajtjes
 - temperatura mesatare (20°C)
 - përdorimi i kufjeve
 - drita e pasme vendosur në minimum

Në varësi të temperaturës së ambientit ose të gjendjes së baterisë së ringarkueshme, koha e ngarkimit mund të jetë më e gjatë, ose koha e luajtjes mund të reduktohet.

Për të kontrolluar nivelin e baterisë


Treguesi i baterisë shfaqet kur ndalohet luajtësi. Kur bateria nuk ka ngarkesë, shfaqet  ose pulson treguesi CHARGE.



Përdorimi i ushqyesit për bateri automjeti

Ushqyesi (i dhënë) për bateri automjeti është për bateri 12 V, me tokëzim negativ (mos e përdorni me bateri 24 V, tokëzim pozitiv).

1 Lidhni ushqyesin për bateri automjeti.



Pas përdorimit të luajtësit në automjet

Hiqeni ushqyesin për bateri automjeti nga foleja e ndezësit të cigares.




- Drejtuesi nuk duhet ta lidhë ose ta vendosë ushqyesin për bateri automjeti gjatë drejtimit të automjetit.
- Rregullojeni kordonin në mënyrë të atillë që të mos pengojë drejtuesin. Gjithashtu mos e vendosni panelin LCD aty kum mund të shohë drejtuesi.
- Pastrojeni folenë e ndezësit të cigares. Nëse është e papastër mund të shkaktojë probleme kontakti ose defekte.
- Përdoreni ushqyesin për bateri automjeti kur motori është ndezur. Nëse përdoret kur motori është fikur, bateria e automjetit mund të bjerë.
- Mos e lini luajtësin apo aksesorët në automjet.

Lidhja me televizorin

Mund të shikoni pamjet në televizor ose në monitor.

1 Lidhni luajtësin me televizorin ose monitorin me anë të përshtatësin audio/video (i dhënë).



- Referojuni udhëzimeve të përdorimit që shoqërojnë pajisjen që do të lidhet.
- Fikeni luajtësin përpara se të vazhdoni.

Luajtja e disqeve


DVDVideo DVDVR VCD CD DATA

Për disqet që mund të luhen shihni “Playable Media” (page 21). Ngarkojeni baterinë paraprakisht ose lidhni ushqyesin.

1 Hapni panelin LCD dhe ndizni luajtësin.

2 Shtypni PUSH OPEN/CLOSE për të hapur kapakun e diskut dhe vendosni diskut.

Vendoseni me anën e luajtshe me përposhtë dhe shtypni lehtë derisa të bëjë “klik”. Mos e prekni sipërfaqen e lenteve.



Ana e luajtjes për poshtë

3 Mbyllni kapakun e diskut dhe shtypni ►.

Luajtësi nis të luajë. Në varësi të diskut, mund të shfaqet një meny. Shtypni ◀/▶/↵ për të zgjedhur një artikull dhe shtypni ENTER.

Shënime për ruajtësin e ekranit

- Kur e lini luajtësin në modalitet pushimi ose ndalimi pa veprim tjetër për mbi 15 minuta, shfaqet një figurë për ruajtjen e ekranit. Figura largohet kur shtypni ►. Për konfigurimin e “Screen Saver”, shikoni faqe 15.
- Luajtësi kalon në pritje, 15 minuta pas nisjes së funksionit të ruajtësit të ekranit. Shtypni ► për të dalë nga modaliteti i pritjes.

Për të rinisur luajtjen nga pika ku ndaluar diskut (Rinis luajtjen)

DVDVideo DVDVR VCD CD

Kur shtypni sërish ► pas ndalimit të luajtjes, luajtësi fillon të luajë nga pika ku shtypni ■.



- Në varësi të pikës së ndalimit, rinisja e luajtjes mund të mos nisë nga pika e përpiktë.
- Pika e rinisjes pastrohet kur:
 - hapni kapakun e diskut.
 - shtypni OPTIONS dhe zgjidhni USB.

Për të luajtur VIDEO CD me funksionet PBC VCD

Kur filloni të luani një VIDEO CD me funksione PBC (Playback Control) shqip: kontrolli i riprodhimit, shfaqet menya për përzgjedhjen tuaj. Për konfigurimin e “PBC”, shikoni faqe 16.

Përdorimi i Shfaqjes së informacionit të luajtjes

DVDvideo DVDVn VCD CD

Mund të kontrolloni informacionin e luajtjes dhe të ndryshoni modalitetin e luajtjes. Kur vendosni numrat, përdorni telekomandën.

1 Shtypni DISPLAY gjatë luajtjes së diskut.

Shembull: Kur luani DVD VIDEO

Artikujt

Menu	
Title	02/07 * 1
Chapter	03/20
Audio	01 5.1CH DDD English
Subtitle	01 English

Title Elapsed 00:12:01

2 Zgjidhni dhe rregulloni secilin nga artikujt duke shtypur ↑/↓ dhe ENTER.

- Title*²
- Chapter*²
- Audio
- Subtitle
- Angle*²
- T.Time (koha e titullit)
- C.Time (koha e kapitullit)
- Repeat
- A-B Repeat*³
- Time Disp. (shfaqja e kohës)

*¹ Kur luhen DVD (modalitet VR), në krah të numri të titullit shfaqet "PL" (listë luajtjeje) ose "ORG" (origjinale).

*² Mund dhe ta zgjedhësh numrin duke përdorur ↑/↓.

*³ Zgjidhni "SET" dhe shtypni ENTER. Zgjidhni pikën A dhe pikën B duke shtypur ENTER.



- Kur luhet CD ose VIDEO CD shfaqen vetëm artikujt e disponueshëm.
- Në varësi të diskut, mund të mos jeni në gjendje të konfiguroni disa artikuj.
- Cilësimi i përsëritjes do të anulohet pas kërkimit për tituj ose për kapituj.

Për të fikur ekranin

Shtypni DISPLAY ose RETURN.

Luajtja e MP3, JPEG dhe skedarëve video DATA

Për skedarë që mund të luhen shikoni "Media të luajtshme" (faqe 21).

Kur caktoni media DATA, shfaqet një listë me albume. Në varësi të diskut, luajtja fillon automatikisht.

1 Shtypni ↑/↓ për të zgjedhur albumin dhe shtypni ENTER.

Shembull: Lista e skedarëve MP3

Dir:001	
MY BEST \	
...	
BEST HITS	
BEST3	
MP3 01 Stardust	
MP3 02 Fire	
MP3 03 Wing	

2 Shtypni ↑/↓ për të zgjedhur skedarin dhe shtypni ENTER.

Luajtja fillon nga skedari i zgjedhur.

Luajtja e skedarëve JPEG

Për të rrotulluar fotografitë JPEG


Shtypni $\leftarrow/\uparrow/\downarrow/\rightarrow$ kur jeni duke parë skedarin fotografik. Rrotulloni çdo skedar. \leftarrow/\rightarrow : Rrotullon foton 90 gradë në kah orar/ kundërorar.

\uparrow/\downarrow : Anasjell foton vertikalisht (lart dhe poshtë)/horizontalisht (majtas dhe djathtas).

Për të shfaqur listën e miniaturave

Shtypni MENU.

Skedarët fotografikë në album shfaqen në 12 nënekrane.



Për të luajtur fotoseri


Zgjidhni “Slide Show” në listën e miniaturave dhe shtypni ENTER.

Për të dalë nga lista e miniaturave

Shtypni MENU për t’u kthyer te lista e albumeve.

Luajtja e të dhënave në pajisje USB

1 Lidhni një pajisje USB në folenë USB.



Pajisja USB

2 Shtypni OPTIONS.

3 Shtypni \uparrow/\downarrow për të zgjedhur “USB” dhe shtypni ENTER.

Për t’u shkëputur nga pajisja USB

Shtypni OPTIONS për të zgjedhur “Disc” dhe shtypni ENTER, pastaj shkëputni pajisjen USB.



- Mos e shkëputni pajisjen USB kur pulson treguesi i përdorimit. Përndryshe mund të shkaktoni dëmtim ose humbje të të dhënave.
- Pajisjet USB që mund të lidhen me luajtësin janë memoriet flash dhe fotoaparate dixhitale. Pajisje të tjera (hab USB etj.) nuk mund të lidhen. Kur lidhet pajisje e pambështetur, shfaqet një mesazh gabimi.
- Disa pajisje USB mund të mos funksionojnë me këtë luajtës.
- Luajtësi mund të njohë pajisje të kategorisë së ruajtjes në masë (MSC) që mbështesin FAT.
- Caktojeni cilësimin LUN në fotoaparatin dixhital në “Single”. Referojuni udhëzimeve shoqëruese të fotoaparatis dixhital.

Rregullimi i cilësisë dhe i madhësisë së figurës

DVDVideo DVDVR VCD DATA

Mund të rregulloni figurën e shfaqur në ekranin LCD.

1 Shtypni **OPTIONS**.

2 Shtypni **↑/↓** për të zgjedhur “LCD Mode” dhe shtypni **ENTER**.

3 Zgjidhni dhe rregulloni secilin nga artikujt e mëposhtëm duke shtypur **←/↑/↓/→** dhe **ENTER**.

- LCD Aspect: Ndryshoni madhësinë e figurës.
- Backlight: Rregulloni ndriçimin.
- Contrast: Rregulloni dallimin midis zonave të shndritshme dhe të errëta.
- Hue: Rregulloni balancën midis ngjyrës së kuqe dhe të gjelbër.
- Color: Rregulloni fortësinë e ngjyrave.
- Default: Ktheni të gjitha cilësimet në vlerat fillestare të fabrikës.

Për të fikur ekranin e menysë

Shtypni **OPTIONS** ose **RETURN**.



Madhësia e ekranit që mund të zgjidhni dallon në varësi të diskut.

Përdorimi i konfigurimit të ekranit


Mund të ndryshoni cilësimet e luajtësit. Cilësimet e parazgjedhura nënvizohen. Disa disqe kanë cilësime të ruajtura luajtjeje, të cilat kanë përparësi.


1 Shtypni **OPTIONS** kur lexuesi është në modalitet ndalimi.


Konfigurimin e ekranit nuk mund ta përdorni gjatë rinisjes së luajtjes. Shtypni dy herë **■** dhe shtypni **OPTIONS**.


2 Shtypni **↑/↓** për të zgjedhur “Setup” dhe shtypni **ENTER**.

3 Shtypni **↑/↓** për të zgjedhur kategorinë e konfigurimit dhe shtypni **ENTER**.

: General Setup

: Audio Setup

: Language Setup




: Parental Control

4 Zgjidhni dhe rregulloni secilin nga artikujt duke shtypur **↑/↓** dhe **ENTER**.

Për të fikur ekranin e konfigurimit Shtypni **OPTIONS** ose **RETURN**.

General Setup

◆ TV Display (vetëm DVD)

<p>4:3 Pan Scan</p>	<p>Zgjidhni këtë kur lidhni me televizor me ekran 4:3. Shfaq automatikisht ekran të gjerë në të gjithë ekranin dhe pret pjesët që nuk i nxë.</p> 
<p>4:3 Letter Box</p>	<p>Zgjidhni këtë kur lidhni me televizor me ekran 4:3. Shfaq një figurë të gjerë me shirita në pjesët e sipërme dhe të poshtme të ekranit.</p> 
<p>16:9</p>	<p>Zgjidhni këtë kur lidhni me televizor me ekran të gjerë ose që ka funksion modaliteti me ekran të gjerë.</p> 

◆ Angle Mark (vetëm DVD VIDEO)

Shfaq shenjën e këndit kur disponohet ndryshimi i këndeve të shikimit gjatë luajtjes së DVD-ve të regjistruara nga shumë kënde. Zgjidhni “On” ose “Off”.

◆ Screen Saver

Shfaqet figura e ruajtësit të ekranit. Për këtë funksion shikoni faqe 11. Zgjidhni “On” ose “Off”.

◆ PBC (vetëm VIDEO CD)

Ky funksion disponohet për VIDEO CD me funksion PBC (kontroll i luajtjes). Për këtë funksion shikoni faqe 11. Zgjidhni “On” ose “Off”.

◆ Default

Çdo funksion kthehet në cilësimet origjinale të fabrikës. Kini kujdes, do të humbisni të gjitha cilësimet.

🔊 Audio Setup

◆ Audio DRC (vetëm DVD)

Qartëson zërat e ulët kur luan DVD që përputhen me “Audio DRC” (kontroll dinamik i rrezes). Zgjidhni “On” ose “Off”.

🗣️ Language Setup

◆ OSD (paraqitja në ekran)

Ndërron gjuhën e paraqitjes në ekran.

◆ Disc Menu (vetëm DVD VIDEO)

Ndërron gjuhën për menynë e diskut.

◆ Subtitle (vetëm DVD VIDEO)

Ndërron gjuhën e titrave

◆ Audio (vetëm DVD VIDEO)

Ndërron gjuhën e kolonës zanore.

🔒 Parental Control

Mund ta kufizoni luajtjen e DVD-ve që kanë funksionin kontrolli prindëror. Kur përdorni këtë cilësim, përdorni telekomandën.

◆ Password (vetëm DVD VIDEO)

Fut ose ndrysho fjalëkalimin. Cakto fjalëkalim 4-shifror.

Për të ndryshuar fjalëkalimin

Zgjidhni “Password” duke përdorur ↑/↓ dhe shtypni ENTER. Zgjidhni “Change” dhe shtypni ENTER. Futni fjalëkalimin aktual dhe fjalëkalimin e ri.

Nëse harroni fjalëkalimin

Futni “1369” për fjalëkalim aktual.

◆ Parental Control (vetëm DVD VIDEO)

Caktoni nivelin e kufizimit. Sa më e ulët vlera, aq më i rreptë është kufizimi. Duhet të caktoni fjalëkalimin përpara caktimit të kontrollit prindëror.

Për të caktuar kontrollin prindëror

Zgjidhni “Parental Control” duke përdorur ↑/↓ dhe shtypni ENTER. Zgjidhni nivelin e kufizimit dhe shtypni ENTER. Futni fjalëkalimin.

Për të luajtur disk për të cilin është caktuar Parental Control

Futni diskun dhe shtypni ►. Shfaqet ekrani për futjen e fjalëkalimit. Futni fjalëkalimin.

Zgjidhja e problemeve

Nëse hasni ndonjë nga vështirësitë e mëposhtme gjatë përdorimit të luajtësit, përdorni këtë udhëzues të zgjidhjes së problemeve për ndihmë të parë të zgjidhjes së problemit përpara se të kërkoni riparim. Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shitësin më të afërt të Sony-t.

Energjia

Pajisja nuk është ndezur.

- ➔ Kontrolloni nëse ushqyesi është lidhur siç duhet (faqe 8).
- ➔ Kontrolloni nëse bateria e ringarkueshme ka ngarkesë të mjaftueshme (faqe 9).

Bateria nuk mund të ngarkohet ose koha e ngarkimit është e gjatë.

- ➔ Nëse kur lidhet ushqyesi pulson treguesi CHARGE, mjedisi mund të mos jetë në temperaturën e duhur. Ngarkojeni baterinë në mjedise me temperaturë midis 5°C dhe 35°C.
- ➔ Ngarkimi zgjat më shumë nëse luajtësi është ndezur. Fikeni luajtësin përpara ngarkimit.
- ➔ Nëse nuk e keni përdorur luajtësin për më shumë se një vit, bateria mund të jetë dobësuar. Kontaktoni me shitësin më të afërt të Sony-t.

Figura

Shfaqen pika të zeza dhe pikat e kuqe, të kaltra dhe të gjelbra mbeten në LCD.

- ➔ Kjo nuk është avari, por veti e strukturës së LCD-së.

Zëri

Nuk ka zë.

- ➔ Luajtësi është në modalitet pushimi ose luajtjeje të ngadalësuar.
- ➔ Luajtësi është në modalitet shpejtimi përpara ose prapa.

Përdorimi

Nuk ndodh gjë kur shtypen butonat.

- ➔ Shtypni HOLD për mbi dy sekonda për të aktivizuar veprimin e butonit (faqe 5). Mund dhe ta anuloni funksionin HOLD duke fikur luajtësin.

Disku nuk luan.

- ➔ Nëse disku kthehet përmbys, shfaqet mesazhi “No Disc” ose “Cannot play this disc.”. Futeni diskun me anën e luajtjes për poshtë (faqe 11).
- ➔ Disku duhet të vendoset mirë derisa të bëjë “klik” (faqe 11).
- ➔ Disku është i papastër ose me problem (faqe 20).
- ➔ Futet disk që nuk mund të luhet. Kontrolloni nëse kodi i rajonit përputhet me luajtësin dhe nëse disku është i finalizuar (faqe 21).
- ➔ Është konfiguruar Parental Control Ndryshoni cilësimin (faqe 16).
- ➔ Ka lagështirë nga kondensimi brenda luajtësit (faqe 19).

Disku nuk e nis luajtjen nga fillimi.

- ➔ Është zgjedhur Repeat Play (faqe 12).
- ➔ Është aktive Resume Play (faqe 11).
- ➔ Luan automatikisht lista e luajtjes së diskut të krijuar. Për të luajtur pjesë origjinale, shtypni dy herë ■ dhe shtypni OPTIONS për të zgjedhur “Original”.


Shfaqet “⊗” dhe lajtësi nuk punon sipas butonit.

- ➔ Në varësi të diskut, mund të mos jeni në gjendje të kryeni disa veprime. Referojuni udhëzimeve shoqëruese të përdorimit të diskut.

Shfaqet “Copyright Lock” dhe ekrani bëhet i kaltër kur luan disk DVD (modalitet VR).

- ➔ Kur luhen materiale me sinjal mbrojtjeje kundër kopjimit, mund të shfaqet një ekran i kaltër dhe mesazhi në fjalë në vend të figurës (faqe 21).

Telekomanda nuk funksionon.

- ➔ Bateritë në telekomandë kanë rënë.
- ➔ Telekomanda nuk është drejtuar drejt sensorit të telekomandës  në lajtës.
- ➔ Sensori i telekomandës goditet nga drita e drejtpërdrejtë e diellit ose një ndriçim i fortë.

Nuk mund të luhen skedarët MP3, JPEG ose video (faqe 21).

- ➔ Formati i skedarëve nuk është i rregullt.
- ➔ Prapashtesa e skedarit nuk është e rregullt.
- ➔ Skedari është i dëmtuar.
- ➔ Skedari është shumë i madh.
- ➔ Kur nuk mbështetet skedari i zgjedhur, shfaqet “Data Error” dhe skedari nuk luhet.
- ➔ Për shkak të teknologjisë së ngjeshjes të përdorur në skedarët video, mund të duhet pak kohë derisa të nisë luajtja.

Lualjtësi nuk punon siç duhet ose nuk fiket.

- ➔ Kur elektriciteti statik etj. shkakton çrregullim në funksionimin e lajtësit, caktojeni çelësin OPERATE në “OFF”, shkëputni ushqyesin dhe lëreni pa lidhur për 30 sekonda.

Montimi

Nuk ka figurë ose zë në pajisjet e lidhura.

- ➔ Rilidheni në mënyrë të sigurt kabllon e lidhjes (faqe 10).
- ➔ Kabloja e lidhjes është e dëmtuar.
- ➔ Kontrolloni konfigurimin e televizorit të lidhur ose të amplifikatorit.

USB

Lualjtësi nuk njih pajisjet e lidhura USB.

- ➔ Rilidheni në mënyrë të sigurt pajisjen USB (faqe 13).
- ➔ Pajisja USB është e dëmtuar.
- ➔ Shtypni OPTIONS për të zgjedhur “USB” (faqe 13).

Masat paraprake

Siguria në rrugë

Mos e përdorni njësinë e monitorit dhe kufjet gjatë drejtimit të automjeteve, biçikletës apo gjatë manovrimit të mjeteve motorike. Nëse veproni kështu mund të shkaktoni rreziqe në rrugë, veç faktit që është e paligjshme në disa shtete. Mund të përbëjë rrezik dhe nëse i mbani kufjet me volum të lartë gjatë ecjes, sidomos në kalimet e këmbësorëve. Duhet të bëni kujdes maksimal ose të ndërprisni përdorimin në raste tepër të rrezikshme.

Për sigurinë

Nëse brenda në mobilie bie diçka e fortë ose lëng, luajtësi duhet të hiqet nga priza dhe duhet të kontrollohet nga personel i kualifikuar përpara se të vihet sërish në punë.

Për burimet e rrymës

- Nëse nuk do ta përdorni për kohë të gjatë luajtësin, sigurohuni ta hiqni nga priza. Për të shkëputur ushqyesin, kapeni te spina - mos e tërhiqni kurrë kordonin.
- Mos e prekni ushqyesin me duar të lagura. Përndryshe ka rrezik goditjeje elektrike.
- Mos e lidhni ushqyesin në elektrotansformator portativ, pasi mund të prodhojë nxehtësi dhe të shkaktojë defekt.

Në raste rritjeje temperature

Në luajtës mund të krijohet nxehtësi gjatë ngarkimit ose kur përdoret për kohë të gjatë. Ky nuk është defekt.

Për vendosjen

- Mos e vendosni luajtësin në vende të ngushta, si rafte librash apo të ngjashme.
- Mos e mbulonni ajrimin e luajtësit me gazeta, mbulesa tavoline, perde etj. Dhe mos e vendosni mbi sipërfaqe të buta si p.sh. qilima.

- Mos e vendosni luajtësin dhe ushqyesit në vende pranë burimeve të nxehtësisë apo në dritën direkte të diellit, në pluhur të tepërt, rërë, lagështi, shi apo ku ka goditje mekanike, apo në automjet me dritare mbyllur.
- Mos e vendosni luajtësin në pozicion të pjerrtë. Luajtësi është krijuar për përdorim vetëm në pozicion horizontal.
- Mbajeni luajtësin dhe disqet larg pajisjeve me magnet të fortë, si furrat me mikrovalë ose altoparlantët e mëdhenj.
- Mos e rrezoni dhe mos e godisni fort. Mos vendosni sende të rënda mbi luajtësin dhe aksesorët.

Për përdorimin

- Nëse luajtësi sillet menjëherë nga vend i ftohtë në vend të ngrohtë ose mbahet në dhomë me shumë të lagështi, mund të ndodhë kondensim i lenteve nga brenda. Nëse ndodh diçka e tillë, luajtësi mund të mos punojë siç duhet. Në këto raste, hiqni diskut dhe lëreni luajtësin pa përdorur për rreth gjysmë ore derisa të avullojë lagështira. Fshini lagështinë nga sipërfaqja e LCD-së me copë etj. Rindizeni pajisjen më vonë.
- Mbajeni pastër lentet e luajtësit dhe mos i prekni. Prekja e lenteve mund t'i dëmtojë dhe t'i shkaktojë defekt luajtësit. Kapakun e diskut mbajeni mbyllur, përveç rasteve kur fusni apo hiqni disqet.
- Disku mund të jetë ende në rrotullim, kur hapet kapaku. Prisi derisa të ndalojë rrotullimi përpara se të hiqni diskut.

Për ekranin me kristale të lëngëta

- Ndonëse prodhohet me teknologji precizioni të lartë, LCD-ja mund të shfaqë me raste pika të ngjyrave të ndryshme. Ky nuk është defekt.
- Mos vendosni dhe mos hidhni sende mbi sipërfaqen e LCD-së. Gjithashtu mos i ushtroni trysni me duar apo bërryla.
- Mos e dëmtoni sipërfaqen e LCD-së me vegla me teh të mprehtë.

Për baterinë e ringarkueshme

- Për shkak të jetëgjatësisë së kufizuar të baterisë, kapaciteti i saj dobësohet me kalimin e kohës dhe pas shumë përdorimeve. Ndërrojeni të vjetrën me të re kur bateria fillon të mbajë vetëm gjysmën e periudhës normale.
- Për të shmangur dobësimin e baterisë, ngarkojeni së paku një herë në gjashtë muaj ose në vit.
- Disa shtete mund ta kenë të rregulluar me ligj hedhjen e baterisë së përdorur për këtë produkt. Konsultohuni me autoritetet vendore.

Për ushqyesin normal dhe ushqyesin për automjet

- Për luajtësin përdorni ushqyesit e dhënë, pasi ushqyes të tjerë mund të shkaktojnë defekt.
- Mos e zbërtheni dhe mos e çmontoni për qëllime dublikimi.
- Mos i prekni pjesët metalike, pasi mund të shkaktoni qark të shkurtër dhe të dëmtoni ushqyesit, sidomos nëse i prekni me sende të tjera metalike.

Për rregullimin e volumit

Mos e ngrini volumin kur dëgjoni pjesë me volum shumë të ulët ose pa sinjal audio. Përndryshe, altoparantët mund të dëmtohen kur luhen pjesë me volum maksimal.

Për kufjet

- Parandalimi i dëmtimeve në dëgjim: Shmangni përdorimin e kufjeve në volume të larta. Ekspertët e dëgjimit këshillojnë kundër luajtjes së pandërprerë, me volum të lartë dhe për kohë të gjata. Nëse vini re tingëllim në veshë, ulni volumin ose ndërprisni dëgjimin.
- Merrni në konsideratë të tjerët: Mbjajeni volumin në nivele mesatare. Kjo ju lejon të dëgjoni tingujt e jashtëm si dhe të merrni në konsideratë njerëzit përreth jush.






Për pastrimin

- Pastroni mobilien, panelin dhe kontrollet me një pëlhurë të butë, disi të njomur me solucion të butë larës. Mos përdorni asnjë lloj pastruesi abraziv, pluhur fërkimi ose solucione si alkooli ose benzina.
- Fshijeni lehtë sipërfaqen e LCD-së me një copë të thatë e të butë. Fshijeni shpesh për të shmangur grumbullimin e papastërtive. Mos e fshini sipërfaqen e LCD-së me copë të lagur. Nëse i hyn ujë, mund të pësojë defekt.
- Nëse figura/zëri ka distorsion, lentet mund të jenë zënë nga pluhuri. Në raste të tilla përdorni furçat e ajrimit që qarkullojnë në treg për pastrimin e lenteve të kamerave. Mos i prekni drejtpërdrejt lentet gjatë pastrimit. Mos përdorni disqe pastrimi apo pastrues disqesh/lentesh.

Shënime rreth disqeve

- Për ta mbajtur diskun pastër, kapeni nga buzët. Mos e prekni sipërfaqen.
- Mos përdorni disqet e mëposhtme:
 - Disqe me formë jostandarde (p.sh. në formë kartoline, zemre).
 - Disqe me etiketë ose ngjitëse përsipër.
 - Disqe me shirit ose material ngjitës përsipër.

Media të luajtshme

Ikona	Karakteristikat
	<ul style="list-style-type: none"> DVD tregtare DVD+RW/DVD+R/ DVD+R DL në modalitet +VR DVD-RW/DVD-R/ DVD-R DL në modalitet video
	DVD-RW/DVD-R/ DVD-R DL në modalitet VR (videoregjistrim)* ¹
	<ul style="list-style-type: none"> CD muzikore CD-R/CD-RW në format CD muzikore
	<ul style="list-style-type: none"> VIDEO CD (duke përfshirë Super VCD) CD-R/CD-RW në format CD video ose Super VCD
	DATA CD* ² /DATA DVD* ³ ose pajisje USB që përmbajnë skedarë MP3, JPEG ose video.



Disa mjete të regjistrueshme mund të mos luhen nga luajtësi për shkak të cilësisë së regjistrimit ose të gjendjes fizike të mjetit, ose të karakteristikave të pajisjes regjistruese dhe të softuerit krijues.

Disku nuk do të luhet nëse nuk është finalizuar siç duhet. Për më shumë informacion, referojuni udhëzimeve të përdorimit për pajisjen e regjistrimit.

*¹ Përmbajtjet me mbrojtje CPRM (mbrojtje e përmbajtjeve për mjete të regjistrueshme) mund të mos luhen. Shfaqet "Copyright Lock".

*² DATA CD-të e regjistruara në ISO 9660 Level 1 ose në formatin e këtij, të zgjeruar, Joliet.

*³ DATA DVD-të duhen regjistruar në UDF (formati universal i disqeve).

Formatet e luajtshme të skedarëve

Lloji	Formati i skedarit	Prapashtesa
Muzikë	MP3 (MPEG-1 Audio Layer III)	".mp3"
Foto	JPEG (format DCF)	".jpg", ".jpeg"
Video	MPEG-4 (profil i thjeshtë)	".mp4"
	Xvid	".avi"



- Luajtja e një hierarkie të ndërlikuar dosjesh mund të marrë pak kohë. Krijoni albume si më poshtë:
 - Numri i hierarkive në mjet nuk duhet të jetë më shumë se dy.
 - Numri i albumeve në mjet duhet të jetë 50 ose më pak.
 - Numri i skedarëve në një album duhet të jetë 100 ose më pak.
 - Numri gjithsej i albumeve dhe i skedarëve në mjet duhet të jetë 600 ose më pak.
- Luajtësi luan skedarët e albumit sipas radhës që janë regjistruar në mjet.



- Luajtësi do të luajë çdo skedar të tabelës më lart, edhe nëse ndryshon formati i skedarit. Luajtja e të dhënave të tilla mund të shkaktojë zhurmë që mund të dëmtojë altoparlantët.
- Disa disa disqe DATA të krijuar në formatin Packet Write nuk mund të luhen.
- Disa disqe DATA të krijuara me shumë sesione mund të mos luhen.
- Disa skedarë JPEG mund të mos luhen.
- Luajtësi nuk mund të luajë skedarë JPEG mbi 3264 (gjerësi) x 2448 (gjatësi) në modalitet normal ose mbi 2000 (gjerësi) x 1200 (gjatësi) në JPEG progresiv.
- Disa skedarë video mund të mos luhen.
- Luajtësi nuk mund të luajë skedarë video mbi 720 (gjerësi) x 576 (gjatësi)/2 gb.
- Luajtësi mund të mos luajë skedarë të caktuar video më të gjatë se 3 orë.
- Luajtësi mbështet format audio MP3 ose AAC për skedarët video MPEG-4.
- Luajtësi mbështet vetëm format audio MP3 për skedarët video Xvid.

- Luajtësi mund të mos i luajë mirë skedarët video të modulimit të lartë në DATA CD. Rekomandohet që skedarët video të modulimit të lartë të luhen në DATA DVD.
- Luajtësi mund të shfaqë emra skedarësh apo albumesh deri në 14 shkronja. Simbolet e veçanta shfaqen si “*”.
- Luajtësi mund të shfaqë vetëm emrin e albumit që luhet aktualisht. Albumet që ndodhen një nivel më lart shfaqen si “\..”.
- Informacioni i luajtjes së disa skedarëve mund të mos shfaqet saktë.

Shënime për disqet tregtare

Kodi i rajonit

Ky është sistemi që përdoret për të mbrojtur të drejtat e autorit. Kodi i rajonit shënohet në paketimin DVD VIDEO sipas rajonit të shitjes. Në luajtës mund të luhen DVD VIDEO-t me etiketë “ALL” ose “2”.



Veprimet për luajtjen e DVD-ve dhe të VIDEO CD-ve

Disa veprime të luajtjes së DVD-ve dhe të VIDEO CD-ve mund të jenë caktuar qëllimisht nga prodhuesit e softuerit. Duke qenë se luajtësi i luan DVD-të dhe VIDEO CD-të sipas përmbajtjes së diskut që kanë krijuar prodhuesit e softuerit, disa veçori të luajtjes mund të mos disponohen. Referojuni gjithashtu udhëzimeve që shoqërojnë DVD-të ose VIDEO CD-të.

Shënime për disqet

Ky produkt është krijuar për të luajtur disqe që ndjekin standardin e kompaktdiskut (CD). Disqet DualDisc dhe disa disqe muzikore të koduara me teknologji për mbrojtjen e të drejtave të autorit nuk ndjekin standardin e kompaktdiskut (CD). Ndaj, këto disqe mund të mos përputhen me këtë produkt.

Specifikimet

Sistemi

Lazeri: Lazer gjysmëpërçues
Sistemi i formatit të sinjalit: PAL (NTSC)

Hyrjet/daljet

A/V OUT (dalja audio/video):

Minifoleja

PHONES (kufjet):

Minifoleja stereo

USB: Foleja USB Type A (për lidhje të memorieve USB)

Ekran me kristale të lëngëta (LCD)

Madhësia e panelit (përafër.):

Gjerësia 18 cm/7 inç (diagonale)

Sistemi drejtues: TFT, matricë aktive

Rezolucioni: 480 × 234

Të përgjithshme

Furnizimi me energji:

DC 12 V 0,95 A (ushqyes)

DC 12 V 1,5 A (ushqyes për bateri automjeti)

Konsumi i energjisë (luajtje DVD VIDEO):

6 W (kur përdoret me kufje)

Përmasat (përafër.):

200 × 42,5 × 155 mm (gjerësi/gjatësi/thellësi) duke përfshirë pjesët e projektimit

Masa (përafër.): 775 g

Kushtet e temperaturës: 5°C deri në 35°C

Kushtet e lagështisë: 25% deri në 80%

Ushqyesi: 110-240 V AC, 50/60 Hz

Ushqyesi për bateri automjeti: 12 V DC

Aksesorët shoqërues

Shihni faqe 8.

Specifikimet dhe dizajni mund të ndryshojnë pa njoftim paraprak.

Indeksi

Identifikuesit numerikë

16:9 15

4:3 Letter Box 15

4:3 Pan Scan 15

A

Audio 7, 12, 16

Audio DRC 16

Audio Setup 16

C

CD 11, 21

D

DATA 12, 21

DVD 11, 21

F

Fjalëkalimi 16

Fotoseri 13

G

General Setup 15

J

JPEG 12, 21

K

Këndi 7, 12

Kodi i rajonit 22

Koha e ngarkimit dhe e luajtjes 9

Konfigurimi 15

L

Language Setup 16

Luajtja 12

M

Media të luajtshme 21

Menya e diskut 16

Modaliteti LCD 14

MP3 12, 21

MPEG-4 (skedar video) 12, 21

MPEG-4 (video file) 12

O

OSD (paraqitja në ekran) 16

P

Pamja LCD 14

Parental Control 16

PBC 11, 16

Përsërit 12

R

Rinis luajtjen 11

Ruajtësi i ekranit 11, 15

S

Skedar video (MPEG-4/Xvid) 12, 21

Sh

Shenja e këndit 15

Shfaqja e informacionit të luajtjes 12

T

Titrat 7, 12, 16

TV Display 15

U

USB 13

V

VIDEO CD 11, 21

X

Xvid (skedar video) 12, 21

Z

Zgjidhja e problemeve 17

4-411-683-11(1) (AL)



* 1 - 4 4 1 1 6 8 3 1 1 / *

Sony Corporation

<http://www.sony.net/>